



12 KORRIK 2024

Kryetarja dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor pritën në një takim kortezie z. Robert Shelby, Kryetarin e Gjykatës në Rrethin Gjyqësor të Utah si dhe znj. Trina A. Higgins, Prokuroren për Rrethin e Utah, të cilët shoqëroheshin nga z. David Wisner, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, si dhe znj. Mary Kate Butterfield dhe z. David Backman, këshilltarë ligjorë, rezidentë në Ambasadë.

Takimi u fokusua mbi organizimin, funksionimin dhe rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u ndalur në mënyrë specifike tek angazhimet e ndërmarra nga Këshilli në drejtim të forcimit të pavarësisë, integritetit dhe transparencës në sistemin gjyqësor. Sfidat me të cilat është ndeshur sistemi i drejtësisë si plotësimi i vakancave, stoku i çështjeve të prapambetura, burimet e limituara financiare, infrastrukturore dhe njerëzore, ishin disa nga çështjet që morën vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve.

Takimi vijoi me shkëmbime prespektivash dhe eksperiencash me qëllim tejkalimin me sukses të sfidave të lartpërmendura, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe rritjes së besimit të publikut. Takimi u përmbyll me dëshirën dhe gadishmërinë e përbashkët për vazhdimin e bashkëpunimit institucional midis dy vendeve, për të përfituar nga përvojat më të mira në drejtim të administrimit gjyqësor.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, prezantoi në Kuvendin e Shqipërisë, në seancë plenare, Raportin Vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023.

Në respektim të detyrimit ligjor, parashikuar nga neni 82 i Ligjit nr. 115/2015 “Për organet e sistemit gjyqësor në Shqipëri”, i ndryshuar, znj. Llagami njohu deputetët e Kuvendit mbi zhvillimet në sistemin gjyqësor me fokus, kryesisht në iniciativat e ndërmarra nga Këshilli në kuadër të mirë-administrimit gjyqësor, ruajtjes së aksesit dhe kapitalit njerëzor, si dhe rritjes së efikasitetit të shërbimeve gjyqësore. Gjithashtu, sfidat e pushtetit gjyqësor si burimet e limituara infrastrukturore, financiare dhe njerëzore dhe nevoja për një qasje kombëtare në adresimin e stokut të çështjeve të prapambetura në gjykatat shqiptare, u artikuluan një zëri nga Kryetarja e Këshillit.

Prezantimi i raportit, vijoi me një sërë pyetjesh nga deputetët e pranishëm në seancë për tu njohur në detaje me aspekte specifike të veprimtarisë dhe kompetencave të Këshillit.



Në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua ceremonia e mirëseardhjes për dy anëtarët e rinj të Këshillit, z. Albens Tabaku dhe z. Bledar Bajri, të zgjedhur nga ana e Kuvendit të Shqipërisë më datë 25.07.2024, nga rradhët e avokatisë.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami mirëpriti anëtarët e rinj të Këshillit, duke ju uruar suksese në kontributin e tyre drejt procesve të rëndësishme që presin sistemin gjyqësor, në drejtim të pavarësisë, integritetit dhe transparencës. Po ashtu znj. Llagami falenderoi znj. Fatmira Luli dhe z. Alban Toro për kontributin e rëndësishëm gjatë ushtrimit të mandatit të tyre dhe Këshilli vijoi me miratimin e deklarimit të mbarimit të mandatit për ta.



17 SHTATOR 2024

Në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u organizua ceremonia e betimit të tetë anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Ornela Naqellari, znj. Alma Kodraliu, znj. Iliba Bezati, znj. Entela Shedula, z. Enkel Peza, z. Rexhep Bekteshi, z. Artan Çupi dhe znj. Lutfie Celami, të përzgjedhur përmes shortit publik të datës 16.09.2024 dhe miratuar me vendimin nr. 505, datë 16.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 146, pika 4, të ligjit 10 019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas përmbajtjes së betimit *“Betohe mësolemnisht se do të respektoj, do të mbroj dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Betohe se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person, parti politike apo subjekt zgjedhor”*, anëtarët e rinj kryen betimin me dorën mbështetur mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



KL Gj me mbështetjen e projekteve të zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI) dhe EU4Justice, organizoi takimin lançues mbi “Planifikimin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemin gjyqësor për 3 vjeçarin e ardhshëm”.

Ky takim mblodhi së bashku anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtues të gjykatave si edhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtar, të cilët diskutuan mbi mundësitë, sfidat dhe prioritetet e sistemit gjyqësor. Takimi u përshëndet nga Kryetarja, znj. Naureda Llagami, z. John Kastning Drejtor i Byrosë Ndërkombëtare kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe Ligjzbatimit (INL) dhe znj. Laura Liguori, Drejtuese e projektit EU4Justice.

Gjatë këtij aktiviteti dy ditor pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime dhe propozime mbi problematikat me të cilat haset gjyqësori, të cilat pritet të analizohen dhe adresohen më tej në Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave për periudhën 2025 – 2028.



- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 mujorit të tretë 2024 vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për 1 gjyqtare për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për 1 gjyqtar për periudhën e vlerësimit 2020-2022, për 2 gjyqtare për vitin 2022.
- Pas përcaktimit me short të relatorëve dhe nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.
- Këshilli miratoi vendimin për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. Enkela (Bajo) Vlora.
- Këshilli miratoi vendimin për transferimin e gjyqtarit z. Olti Skrame në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të:
 - Z. Gerti Shani në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë;
 - Z. Klemend Kajana, znj. Aida Mertiri dhe znj. Majlinda Miska, në pozicionet ndihmës ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
 - Znj. Enida Lamçe dhe znj. Aneta Strakosha në pozicionet ndihmës ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimet për verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, për 7 kandidatë.
- Gjithashtu, Këshilli vendosi verifikimin e plotësimit për 1 kandidat të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në:
 - Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, datë 24.05.2023 dhe nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në:
 - Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim;
 - Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, 490, 491, 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 9 kandidatë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për 1 kandidate.
- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për 2 kandidatë.
- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për 5 kandidatë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për 17 kandidatë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan për 1 kandidate.
- Këshilli miratoi hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 5 (pesë) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konkretisht 2 (dy) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 3 (tre) pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.
- Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për:
 - 6 (gjashtë) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

- 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 - 6 (gjashtë) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pas shprehjes së pëlqimit nga ana e magjistratëve, **Këshilli miratoi vendimet për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve:**
 - Z. Alban Veçani, z. Arbër Çela, z. Xhevdet Lika, z. Ervin Sulaj, z. Rudi Laze dhe znj. Marjola Beluli në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 - Znj. Emirjana Dimo në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 - Znj. Sonjela Voskopi, znj. Ersida Bajgora dhe z. Artan Jahollari, znj. Matilda Fetau, z. Sokol Shehu dhe z. Artan Çupi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - Znj. Gentiana Xhelili në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
 - Pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe figurës, Këshilli vendosi **kualifikimin për emërim të 32 kandidatëve për magjistratë** të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024. Në vijim të kësaj procedure, Këshilli **miratoi vendimet për emërimin gjyqtar të 32 kandidatëve për magjistratë të kualifikuar për emërim.**
 - Këshilli miratoi vendimet përkatëse për kualifikimin, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, **për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024 për 9 kandidatë.**
 - Këshilli vendosi **për kualifikimin për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, për 6 kandidatë fitues.**
 - Këshilli vendosi caktimin e gjykatave dhe **gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale** të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, **viti akademik 2024-2025.**
 - Këshilli vendosi miratimin e **2 rregulloreve**, konkretisht:
 - **“Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje”;**
 - **“Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në KLGJ dhe sistemin gjyqësor”.**
 - Këshilli vendosi mbi miratimin e **udhëzuesit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor”.**
 - Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli caktoi përkohësisht **znj. Edona Vajushi, gjyqtare për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.**
 - Këshilli miratoi listën përfundimtare të gjyqtarëve që morën pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i cili u hodh më datë 16.09.2024 në ambientet e Këshillit ora 10:00 në prani të përfaqësuesve të partive politike, mediave dhe publikut.
 - Pas kësaj procedure, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e radhës plenare me vendimin nr. 505, datë 16.09.2024, **miratoi zgjedhjen e 8 (tetë) anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.**

DISIPLINA DHE TRANSPARENCA



Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe ka konkluduar me dhënien e vendimeve, konkretisht:

- **Me vendimin nr. 357, datë 11.07.2024 është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 97, datë 29.02.2024** të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}” dhe vijimin e shqyrtimit të tij.
- **Me vendimin nr. 523, datë 24.09.2024 është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 436 datë 19.07.2023** të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}” dhe vijimin e shqyrtimit të tij.


- Me vendimin nr. 524, datë 24.09.2024 është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 437 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}” dhe vijimin e shqyrtimit të tij.
- Me vendimin nr. 525, datë 24.09.2024 është vendosur shfuqizimi vendimit nr. 438, datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}” dhe vijimin e shqyrtimit të tij.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi 9 kërkesa për caktimin e 12 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar 9 kërkesa për informacion, të ardhura përmes postës elektronike, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar 138 shkresa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KLGJ-së (Korrik-Shtator 2024):



- 13 mbledhje plenare
- 227 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 17 akte kolektive, korrik 2024
 - 1 akt kolektiv, gusht 2024
 - 26 akte kolektive, shtator 2024
 - 146 akte individuale, korrik 2024
 - 0 akte individuale, gusht 2024
 - 25 akte individuale, shtator 2024

Pjesa tjetër përfshihen 1 akt normativ nënligjor, 10 rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.



KLJ FACEBOOK

Ndjekës në total

3014

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”, Rruga “Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

e-mail: kontakt@klgj.al